

VENDIM
Nr.622, datë 27.9.2007

PËR ORGANIZIMIN E CEREMONISË MORTORE NË NDERIM TË AT ZEF PLLUMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, dhe të pikës 10 të kapitullit VII të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Ceremoniali zyrtar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e ceremonisë, jo të plotë zyrtare, në nderim të figurës së spikatur të qëndresës antikomuniste At Zef Pllumi, i cili ndërroi jetë më 25.9.2007, pas një sëmundjeje të rëndë.

2. Ngritjen e një komisioni shtetëror për kryerjen e ceremonisë mortore, në përbërje të të cilit të jenë zëvendëskryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z.Fatos Beja, zëvendëskryeministri z.Gazmend Oketa, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z.Ylli Pango, këshilltari i Presidentit për Sigurinë Kombëtare, z.Illir Kulla, znj.ArencaTrashani, deputete, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, z.Aurel Plasari, drejtori i Përgjithshëm i Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë z.Simon Miraka, z.Bardhyl Londo, shkrimtar, z.Fahri Balliu, publicist e botues, dhe një përfaqësues i Protokollit të Shtetit.

3. Trupi i të ndjerit të pritët me ceremoni në aeroportin “Nënë Tereza”, ditën e premte, 28 shtator 2007, ora 14⁰.30.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5.Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Protokolli i Shtetit për organizimin e ceremonialit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha